

VENDIMET E BORDIT TË DATËS 15 NËNTOR 2019

Vendimi 2019-37 Detyrat e Këshillit Profesional

- Z. Shkëlzen Domi ka dhënë dorëheqje nga Këshilli Profesional, dhe e njëjta është miratuar nga Bordi me shumicë votash.

- Duke qenë se Këshilli Profesional me vetëm një anëtar nuk është më funksional, Bordi i FTK-së vendos t'i merr përsipër detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Profesional deri në një zgjidhje tjetër.

Vendimi 2019-38

Emërimi i z. Osman Reçica Selektor për Fed Cup 2020

-Bordi me shumicë votash miraton propozimin që z. Osman Reçica të emërohet selektor për Fed Cup 2020.

Vendimi 2019-39

Ceremonia e Laureatëve 2019

- Bordi me shumicë votash aprovon datën 21 dhjetor 2019 për të organizuar Ceremoninë e Laureatëve 2019.

- Ceremonia do të mbahet në Hotel Sirius.

Vendimi 2019- 40

Anëtarët e Komisionit për Çmime

- Me shumicë votash bordi miraton propozimin që në këshillin për çmime për Laureatët e 2019 të emërohen 3 anëtarë, z. Gëzim Mehmedi, z. Agim Islami, dhe anëtari i tretë i cili do të propozohet nga trajnerët.

-Anëtarët do të kontaktohen nga Sekretarja për të konfirmuar pjesëmarrjen dhe të fillojnë angazhimin. Njëherësh, duhet bërë ftesa për kandidime / vetëkandidime për disa prej çmimeve (trajnerë, punëtori i vitit, refer, etj.)

Vendimi 2019- 41

Propozimet e klubeve për sezonin dimëror

- Bordi me shumicë votash merr vendim të i ftojë klubet të dorëzojnë projektet/idetë e tyre për stërvitjen e tenisistëve të tyre më të mirë gjatë sezonit dimëror.

- Afati për të dërguar projekt-propozimet e detajuara është 30 nëntori, ndërkaq kërkesat teknike i përcakton administrata.

Vendimi 2019-42

Iniciativa për Beach Tennis

-Bordi miraton iniciativën e z. Agim Islami për përfshirjen e Beach Tennis në kuadër të Federatës.

- Bordi merr vendim që Beach Tennis fillimisht të jetë vetëm diciplinë shtesë, dhe të mos ketë trupa të veçantë në kuadër të Federatës pa u rritur interesimi dhe masovizuar ky lloj i tenisit.

- Bordi e ngarkoi Komisioneren e Garave që t'i përfshijë në kalendarin e garave 2020 katër turne në Beach Tennis për grupmoshat U12 e më lartë. Ndërsa nga Administrata do të sigurohen edhe pajisjet bazë (reketa të Beach Tennis, dhe topa) të cilat do të ofrohen në huazim për tenistët kur mbahen turnetë.

Vendimi 2019-43

Përmbyllja e Kalendarit Zyrtar të Garave 2019 dhe Rankingu Përfundimtar i Vitit

- Bordi me shumicë votash aprovoi përmbylljen e kalendarit zyrtar të garave 2019.

- Bordi po ashtu përcaktoi se mbyllja e kalendarit, gjegjësisht e turneve Masters për një grupmoshë të caktuar, njëherësh përcakton edhe mbylljen e sezonës për sa i përket rankingut përfundimtar të vitit për atë grupmoshë. Ndërkohë që, rankingu zyrtar vazhdon të publikohet çdo javë.

Vendimi 2019-44

Ndryshimi i Rregullores për Masters 2019

- Bordi me shumicë votash miraton kërkesën e lojtarëve për ndryshimin e rregullores së Masters që nga grupet (kur janë dy grupe) dy të parët e grupit të kualifikohen në gjysmëfinale, e jo vetëm i pari direkt në finale.